

UDHËZIM
Nr.8, datë 16.11.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.15, DATË 24.7.2007 “PËR KRITERET DHE
PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCEVE, AUTORIZIMEVE DHE
CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN
RRUGOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

Neni 1

Paragrafi i dytë i pikës 4 të nenit 8, ndryshon si më poshtë:

“Në transportin e udhëtarëve, subjekti transportues, pas përfitimit të certifikatave të kontrollit teknik të lëshuara nga Qendra e Kontrollit Teknik (QKT), paraqitet pranë komisionit të DPSHTRR-së në përfundim të aktvlerësimit në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve në përputhje me anekset 1, 2 dhe 3 të udhëzimit nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi